

GI

Udhëzues

për Vlerësimin e Kushteve
dhe Ndikimeve të

Treguesve Gjeografikë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



IGE | IPI

Udhëzues

për Vlerësimin e Kushteve

dhe Ndikimeve të

Treguesve Gjeografikë

Ky udhëzues është zhvilluar në kuadër të Projektit për Pronësi Intelektuale Kolumbi-Zvicër (COLIPRI) të Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) dhe është zbatuar nga Instituti Federal Zviceran për Pronësi Intelektuale (IPI).

Përkthimi dhe publikimi u mundësuan nga projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale, një projekt i Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) i zbatuar nga Zyra Federale Zvicerane për Pronësinë Intelektuale (IPI).

Data

Qershor 2017

AUTORËT

Guillén Calvo, Drejtor

Cristina Consuegra dhe Laura Estrada, Konsulentë

www.insuco.com



INSUCO

KOORDINUAR NGA:

Nathalie Hirsig, Koordinatore projekti

Projekti për Pronësi Intelektuale Kolumbi-Zvicër (COLIPRI)

Instituti Federal Zviceran për Pronësi Intelektuale (IPI)

MIRËNJOHJE

Andrea Benedetto (Universiteti Kombëtar i Cuyo-s, Argjentinë), Andrea Marescotti (UNIFI, Itali), Beatriz Mogollón (Laera Group, Kolumbi), Claire Philippoteaux (COLIPRI, Kolumbi), Dominique Barjolle (ETH, Zvicër), Erik Thévenod-Mottet (IPI, Zvicër), Florence Arsonneau (Diversiteti & Zhvillimi, Francë), Giovanni Belletti (UNIFI, Italy), Guillén Calvo (INSUCO, Kolumbi), Luis Fernando Arenas (Ministria e Kulturës, Colombia), Marcelo Champredonde (INTA, Argjentinë), Matthias Niggli (IPI, Zvicër), Nathalia Soto (INSUCO, Kolumbi), Tobias Eisenring (FiBL, Zvicër) si dhe artizanët e prodhuesit e Carmen de Viboral (Antioquia, Kolumbi) dhe Provincia e Vélez-it dhe Ricaurte-s (Santander dhe Boyacá, Kolumbi).

Akronime dhe Shkurtime

COLIPRI	Projekti për Pronësinë Intelektuale Kolumbi-Zvicër
ETH	Instituti Federal Zviceran i Teknologjisë
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
FIBL	Instituti Kërkimor për Bujqësi Organike
GI	Tregues gjeografik
INTA	Instituti Kombëtar Teknologjik Bujqësor, Argjentinë
INVIMA	Administrata Kombëtare e Ushqimit dhe Barnave, Kolumbi
IP	Pronësia Intelektuale
IPI	Instituti Federal Zviceran i Pronësisë Intelektuale
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
LEDA	Agjencia Lokale për Zhvillim Ekonomik
M&Zh	Monitorim dhe Zhvillim
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
TGJM	Tregues Gjeografik i Mbrojtur
SAFA	Sistemet e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Ushqimit dhe Bujqësisë
SECO	Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike
UNIFI	Universiteti i Firences
WIPO	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie	V
1. Hyrje	VII
2. Aspekte të Përgjithshme të Instrumentit	
2.1 Si u zhvillua instrumenti?	8
2.2 Për çfarë është instrumenti? Kush është përdoruesi i synuar?	9
2.3 Kur të aplikoni për instrumentin	10
2.4 Përshtatja e instrumentit	12
3. Përshtatja e instrumentit	
3.1 Evidentimi i elementëve kontekstualë	
3.1.1 Harta e Palëve të Interesuara	13
3.1.2 Kuadri kohor	17
3.2 Vlerësimi i kushteve dhe ndikimeve të procesit të TGJ	19
3.2.1 Seminar Praktik për Vlerësimin	19
3.2.2 Matricat e Vlerësimit	22
3.3 Analizimi i informacionit dhe krijimit të Planit të Veprimit	56
4. Përfundime	60
5. Fjalor	61
6. Bibliografi	65

Parathënie

Pronësia Intelektuale (PI) kuptohet si një grup të drejtash që rrjedhin nga një veprimtari artistike, letrare, novatore, industriale apo tregtare. Ky përkufizim u përshtatet në mënyrë të përkryer treguesve gjeografikë (TGJ). Shumë larg së qenurit fillimet e një veprimtarie prodhuese, janë në fakt rezultati i shumë veprimeve dhe ndërveprimeve ndërmjet njerëzve të ndryshëm, tokës dhe tregut të tyre.

Në vitet e fundit kemi qenë një forcë drejtuese e përdorimit të TGJ-ve si mjete për arritjen e objektivave specifike, përfshirë konkurrencën e produkteve agro-ushqimore dhe artizanale, ndërtimin e partneriteteve dhe zhvillimin rural. Thënë ndryshe, kemi promovuar TGJ-të si një mjet i vlefshëm për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Njësoj si markat tregtare, patentat, dizenjt industrialë dhe të gjitha mjetet e tjera të PI, TGJ-të nuk përdoren vetëm për mbrojtje por edhe si pjesë e një strategjie për përmbushjen e këtyre objektivave. Për shembull, në Kolumbi tashmë ka më shumë se 20 TGJ të mbrojtur, bujqësorë dhe artizanale dhe si rezultat përfituesit e tyre - të grupuar në shoqata prodhuesish,

federata, kooperativa dhe para-kooperativa - mund të nisin të përdorin në mënyrë strategjike të drejtat që u siguron mbrojtja.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë një metodë dhe një plan për vlerësimin kolektiv të produktit që do të pozicionohet, në mënyrë që palët e ndryshme të interesuara të arrijnë qëllimet që kanë përcaktuar. Ky udhëzues trajton secilën prej temave që duhet të shqyrtojnë një grup apo shoqatë palësh të interesuara me qëllim që të vlerësojnë saktë dhe të krijojnë një ndikim me TGJ-në e tyre, nga të kuptuarit e aspekteve ligjore të mekanizmit deri në përzgjedhjen e efekteve të dëshiruara sociale dhe ekonomike të TGJ-së dhe metodave për përzgjedhjen e tyre.

Shpresojmë që ky udhëzues të përshtatet nga të gjithë palët tona të interesuara të TGJ-ve në mënyrë që ata të rrisin potencialin e tyre të plotë të përfitimeve sociale, ekonomike dhe mjedisore në rajonet e tyre.

José Luis Londoño Fernández
Zëvendës Mbikqyrës i Zyrës Mbikqyrëse
të Industrisë dhe Tregtisë
Qershor 2017

1. Hyrje

Projekti për Pronësinë Intelektuale Kolumbi-Zvicër (COLIPRI) është një bashkëpunim ndërmjet qeverive kolumbiane dhe zvicerane (2013-2018). Një nga qëllimet e tij është të përforcojë sistemin e mbrojtjes për treguesit gjeografikë në Kolumbi dhe këtu përfshihet zhvillimi i një instrumenti për të vlerësuar ndikimet e treguesve gjeografikë (TGJ).

Vlerësimi i ndikimeve të TGJ-ve është thelbësor për të kuptuar se si ky mjet i veçantë i pronësisë intelektuale ka bërë të mundur arritjen e qëllimeve të dëshiruara si dhe për evidentimin e efekteve të zbatimit të TGJ-ve.

Ky udhëzues ofron një mjet për forcimin e proceseve dhe vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve të TGJ-ve ndërmjet organizatave me bazë në komunitet që kanë apo dëshirojnë të kenë këtë tipar dallues, si dhe ndërmjet institucioneve publike dhe private që rregullojnë apo mbështesin proceset.

2. Aspekte të Përgjithshme të Instrumentit

2.1 Si u zhvillua instrumenti?

Zhvillimi i instrumentit nisi me një shqyrtim të gjerë të literaturës ekzistuese mbi matjen e ndikimeve të TGJ-ve nëpër botë. Kjo punë përfshiu shqyrtimin e ndikuesve të propozuar nga autorë të ndryshëm me qëllim studimin e ndikimeve të produkteve të TGJ-ve në disa vende, përfshirë Xhamajkën, Meksikën, Francën, Italinë dhe Greqinë, përveç të tjerave. U rishikuan gjithashtu edhe mjetet e vlerësimit të ndikimit, përfshirë Sistemet e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Ushqimit dhe Bujqësisë (SAFA), të zhvilluara nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO). Kjo fazë çoi në zhvillimin e versionit të parë të instrumentit me dimensionet dhe treguesit e vet përkatës.

Pastaj u kryen vizita në dy komunitete TGJ në Kolumbi. Këto dy udhëtime në terren ishin thelbësore për shqyrtimin dhe forcimin e instrumentit. Duhet të sqarohet që qëllimi i vizitave ishte prezantimi dhe diskutimi rreth instrumentit, si hapa kyç për zhvillimin e tij dhe jo si hapa pilot në zbatimin e tij. Instrumenti u testua gjithashtu gjatë një seminari praktik me përfaqësues nga Zyra Kolumbiane për Pronësinë Intellektuale, Ministria e Bujqësisë, institucione përkatëse në nivele kombëtar dhe ndërkombëtar, konsulentë dhe juristë që mbështesin këto procese dhe anëtarë të organizatave drejtuese të TGJ-ve. Së fundmi, akademikët dhanë vlerësimin e tyre.

2.2 Për çfarë është instrumenti? Kush është përdoruesi i synuar?

Objekti kryesor i instrumentit është të vlerësojë kushtet e nevojshme për ndërtimin e një TGJ-je si dhe ndikimet e procesit. Vlerësimi përqendrohet kryesisht në nivelin territorial, ku njësitë e analizës janë palët e ndryshme të interesuara në zinxhirin e vlerës (prodhuesit, përpunuesit, etj.) si dhe organizatat që janë të ngarkuara me menaxhimin e TGJ-së.

Për më tepër, ky instrument synon të forcojë procesin e TGJ përmes (i) vetë-vlerësimit të kryer nga palët e interesuara, (ii) evidentimit të mësimave të marra dhe praktikave më të mira dhe (iii) zhvillimit kolektiv të hapave pasues që do të ndërmerren nga komunitetet që kanë interes tek TGJ, në mënyrë që të përmbushin objektivat ose pritshmëritë e tyre.

Kështu, ky instrument është zhvilluar për t'u përshtatur nga:

- Prodhuësit që përbëjnë hallkat e ndryshme të zinxhirit të vlerës së produkti me TGJ apo që aspiron të ketë një të tillë.
- Organet që mbështesin proceset, përfshirë OJQ-të, studiot e konsulencës dhe ato ligjore, qeveritë vendore dhe ato rajonale, institutet e kërkimit dhe universitetet.
- Organet që promovojnë mekanizmat e mbrojtjes dhe/ose shqyrtojnë aplikimet për mbrojtje, përfshirë zyrat kombëtare të pronësisë intelektuale dhe institucione të tjera.

2.3 Kur të aplikoni për instrumentin

Pavarësisht se TGJ-të janë të vendosura në kontekste të veçanta në hapësirë dhe kohë, është e vështirë që proceset e tyre të mendohen si lineare. Shpesh produktet regjistrohen si TGJ, por prodhuesve nuk u jepet domosdoshmërisht përgjegjësia e menaxhimit të vulës së TGJ. Në raste të tilla, produktet nuk kanë sistemet e tyre të kontrollit dhe një kod praktike të zhvilluar nga një grup përfaqësuesish të prodhuesve.

Si i tillë, duhet të bëhen hetime të kushteve të nevojshme për ngritjen e një TGJ-je përpara vlerësimit të ndikimeve të procesit. Këto kushte duhet të lehtësojnë (i) zhvillimin e një vlerësimi nëse TGJ po zbatohet ose jo dhe në çfarë konteksti dhe (ii) evidencimin e një lidhjeje të mundshme shkak dhe pasojë ndërmjet pranisë së kushteve të nevojshme dhe ndikimeve të vëzhguara, pasi janë vlerësuar këto të fundit. Duhet të sqarohet se vlerësimi i kushteve të tilla mund të kryhet në pika të ndryshme gjatë procesit, gjë që në fakt mund të kontribuojë në të kuptuarit e ecurisë së tyre.

Pasi të jenë vlerësuar kushtet, hapi i mëtejshëm është të zbatohet pjesa e dytë e instrumentit, e cila kërkon të evidentojë ndikimet pozitive dhe negative, përfshirë ato të pritura dhe ato të papritura, të procesit të TGJ. Është e rëndësishme të përmendet se koha e ndikimeve nuk do të përkohë domosdoshmërisht me kronologjinë e procesit; ndikimet mund të bëhen të dukshme kur palët e interesuara të zinxhirit të vlerësisin procesin e aplikimit për mbrojtje, gjatë aktiviteteve për të arritur një marrëveshje mbi atë produkt apo produkte që do të mbrohen, gjatë procesit të zgjedhjes së drejtuesve apo të vlerësimit të vlerës kulturore të produktit, ose në një kohë tjetër.



Rast Studimor #1: Qeramikat e Carmen de Viboral

Procesi i aplikimit për TGJ “Qeramikat e Carmen de Viboral” ishte një iniciativë e kryetarit të bashkisë së Carmen de Viboral, e cila u zbatua nga Instituti i saj për Kulturë dhe Turizëm, me mbështetjen e institutit shtetëror të promovimit të zejtarisë. Mbrojtja e TGJ u dha në vitin 2011. Në vitin 2013 u krijua Shoqata e Prodhuesve të Qeramikës (Aproloza), e cila u autorizua nga Zyra Kolumbiane për Pronësinë Intelektuale, po atë vit, për të përdorur vulën e TGJ. Ndërkohë që TGJ i tyre ka ngelur që prej asaj kohe, në zbatimin e tij kanë ndikuar faktorë historikë, si dhe çështje me kushtet e nevojshme që ky mjet ka për qëllim të vlerësojë. Në këtë rast, nuk kishte një numër të madh palësh të interesuara të zinxhirit të vlerës që morën pjesë gjatë procesit të aplikimit. Kjo e vështirësoi përshtatjen e TGJ-së dhe gjurmimin e objektivave që e kishin motivuar atë. Gjithashtu, shoqata tregtare dhe palët e interesuara të zinxhirit të vlerës ende nuk kanë përparuar të zhvillojnë bashkërisht një kod praktike që do të mbështeste deklaratën e TGJ-së, do të përcaktonte karakteristikat e produktit të mbrojtur dhe gjithashtu mekanizmat për të monitoruar sistemin e kontrollit të përdorimit të vulës së TGJ. Së fundmi, ky TGJ u shfaq në një kontekst të fragmentuar shoqërisht, për shkak të periudhave të luftës në industrinë e qeramikës së komunës, - lufta kryesore ishte kriza financiare që preku fabrikat kryesore të qeramikës në vitet '90.



2.4 Përshtatja e instrumentit

Ashtu si zhvillimi i këtij instrumenti u theksua gjatë punës në terren, përdoruesve u rekomandohet ta shqyrtojnë përpara zbatimit me qëllim që ta përshtatin në kontekstin e tyre:

- Termat mund të përshtaten për t'u kuptuar më mirë.
- Lidhja dhe rëndësia e kushteve dhe treguesve mund të vlerësohen paraprakisht dhe mund të zgjidhen në përputhje me secilin rast të veçantë.
- Disa tregues ndikimi mund të përshtaten sipas llojit të produktit.

Në varësi të mënyrës se si përparojnë gjërat, disa kushte dhe tregues mund të humbin vlefshmërinë e tyre apo do të duhet të ri-dizenjohen si objektiva ose pritshmëri të reja të lidhura me TGJ dhe/ose do të evidentohen ndikimet që nuk përfshihen në treguesit e propozuar.

Ky instrument mund të përdoret edhe si një pikënisje për zhvillimin e të tjerëve që e plotësojnë atë, siç janë:

- Vlerësimi i llojit të shenjës dalluese që u përgjigjet më mirë sfidave dhe pritshmërive të komuniteteve.
- Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit (M&V) me tregues si: numri i palëve të interesuara brenda dhe jashtë sistemit të TGJ-ve, të dhënat mbi sasi të dhe vëllimin e prodhimit, etj.
- Krijimin e planeve të veprimit të bazuara në rezultatet e marra

3. Përshtatja e instrumentit

3.1 Evidentimi i elementëve kontekstualë

Përpara vlerësimit të kushteve dhe ndikimeve, duhet të krijohet një hartë e palëve të interesuara e lidhur me procesin si direkt, ashtu edhe indirekt, si dhe afatet kohore të ngjarjeve kryesore që lidhen me produktin TGJ si dhe faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në të. Këto dy aktivitete do të përmirësonin diskutimin mbi kushtet dhe ndikimet e procesit të TGJ-ve duke bërë të mundur referimin tek palët e interesuara të përfshira në hartë dhe evidentimin e ndryshimeve të procesit që kanë ndodhur gjatë gjithë historisë së tij.

3.1.1 Harta e Palëve të Interesuara¹

Objekti i këtij aktiviteti është të evidentojë dhe planifikojë palët e interesuara që janë të përfshira direkt ose indirekt në procesin e TGJ dhe të krijojë lidhje ndërmjet tyre për të kuptuar rolin që luajnë ata në lidhje me produktin. Përpara kryerjes së këtij aktiviteti është ide e mirë të evidentoni një palë të interesuar "spirancë", pra një palë të interesuar vendore që e njeh rajonin dhe që ka njohuri të paanshme në lidhje me procesin e TGJ-ve. Kjo palë e interesuar do të jetë kyçe në evidentimin e atyre që do të përfshihen në një listë fillestare që më vonë do të vërtetohet dhe zgjerohet nëpërmjet intervistave dhe seminareve praktikë të hartuar për këtë qëllim.

1. Bryson, J. M. (2004). Çfarë të bëni kur palët e interesuara kanë rëndësi: evidentimi i palëve të interesuara dhe teknikat e analizimit. Shqyrtimi i menaxhimit publik, 6(1), 21-53.



Kjo hartë e palëve të interesuara do të përdoret për të dërguar ftesa për seminarin praktik për vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve (shihni pjesën 3.2) dhe si e tillë ajo duhet të vërtetohet për sa i përket legjitimitetit, rëndësisë dhe lidhjen e palëve të interesuara, të identifikuara si para ashtu edhe gjatë seminarit. Harta pritet të lehtësojë gjithashtu vlerësimin e sa më poshtë:

- Autoritetin vendimmarrës të palëve të ndryshme të interesit.
- Interesin e tyre në procesin e TGJ-ve si dhe pozicionin që kanë marrë apo që mund të marrin për sa i përket zbatimit të TGJ-së.
- Ndryshime të mundshme në marrëdhëniet ndërmjet tyre (p.sh.: bashkëpunim, besim, solidaritet, etj.).
- Mbërritja dhe largimi i palëve të reja dhe atyre ekzistuese të interesuara.

Pyetjet për të drejtuar procesin e evidentimit të palëve të interesuara përfshijnë:

- Kush janë njerëzit dhe organizatat e lidhura me TGJ?
- Çfarë roli luajnë këta palë të interesuara?
- Si mund të grupohen? (Për shembull: zinxhiri i vlerës i produktit të mbrojtur–prodhuesit, organizatat dhe shoqatat e tregtisë –institucione publike dhe private që mbështesin procesin, sektori arsimor dhe sektorët ekonomikë, si industritë e turizmit dhe restoranteve, etj.)

Harta e thjeshtuar e palëve të interesuara për rastin e TGJ të xhelatinës Gujava "Bocadillo Veleño"



Kjo hartë u krijua në 6 maj 2017 dhe pala e interesuar "spirancë" ishte partner i projektit COLIPRI. Pastaj harta u nda, u shtua dhe u miratua në një seminar praktik me pjesëmarrjen e palëve të interesuar nga zinxhiri i vlerës, i cili u zhvillua në Vélez. Ngjyrat përfaqësojnë si ishin grupuar të gjithë palët e interesuara sipas: i) zinxhirit të vlerës dhe lidhjeve të tyre (përfshirë partnerët e jo-partnerët), ii) shitësit, iii) institucionet territoriale, iv) sektori i arsimit, si dhe v) sektorët e tjerë. Ky grupim gjithashtu kërkonte të ndante palët aktuale të interesit nga palë të mundshme interesi duke përdorur një vijë të pandërprerë për t'iu referuar aktualëve dhe një vijë të ndërprerë për t'iu referuar palëve të mundshme.



Rast Studimor #2: TGJ Xhelatina Gujava Bocadillo Veleño

Për dhjetë vitet e fundit, palët e interesuara të zinxhirit të vlerës së TGJ-së së xhelatinës gujava Bocadillo Veleño kanë qenë kuriozë rreth mundësisë së një treguesi gjeografik që mund të ndihmonte në mbrojtjen e tyre nga falsifikimet dhe t'u jepte traditës e njohurive të tyre teknike një vlerë të re. Në vitin 2013, Projekti për Pronësi Intelektuale Kolumbi-Zvicër (COLIPRI) e shtyu përpara këtë aspiratë dhe në vitin 2017 Zyra Kolumbiane për Pronësinë Intelektuale e miratoi aplikimin e tyre për mbrojtje të TGJ. Ky ka qenë një proces i përbashkët me pjesëmarrjen e prodhuesve nga lidhje të ndryshme të zinxhirit të vlerave. Edhe përpara zbatimit të TGJ, procesi ka pasur ndikim tek treguesit socialë, përfshirë besimin ndërmjet palëve të interesuara, pjesëmarrjen e lidhjeve më të prekshme të zinxhirit të vlerës dhe bashkëpunim e solidaritet ndërmjet palëve të interesuara me qëllimin e arritjes së objektivave të përbashkët. Ka pasur gjithashtu ndikim tek treguesit kulturorë, përfshirë vlerësimin e produktit dhe tregtitë e ndryshme të lidhura me të. Për të dhënë një shembull, prodhuesit e gjethes bijao (që tradicionalisht është përdorur për të mbështjellë xhelatinën gujava) të shoqatës Bijao Veleño paraqitën një projekt në Programin e Partneriteteve Prodhuese të drejtuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në të cilin shoqata Asoveleños e prodhuesve të xhelatinës gujava Vélez është zotuar për angazhimin e saj si një partner biznesi. Për ta arritur këtë, nuk është vetëm thelbësore që të paktën një palë e interesuar nga secila hallkë e zinxhirit të vlerës të thirret për të marrë pjesë, por që ky person të njihet si një palë e interesuar legjitime, e rëndësishme dhe e përshtatshme në nivelin vendor.

3.1.2 Kuadri kohor

Qëllimi i këtij ushtrimi është të krijojë një regjistrim kronologjik të piketave apo ngjarjeve kryesore historike në lidhje me produktin e mbrojtur, duke përfshirë gjithashtu të gjithë faktorët e jashtëm që ndikojnë në procesin e TGJ. Rekomandohet që kjo të bëhet nëpërmjet një seminari praktik dhe intervistave me palët e interesuara që janë të përfshirë në proces direkt apo indirekt. Më vonë, informacioni i mbledhur duhet t'u prezantohet pjesëmarrësve në seminar për vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve (shihni pjesën 3.2), ku ata të kenë mundësi ta zgjerojnë dhe vërtetojnë atë.

Qëllimi i evidentimit të piketave apo ngjarjeve kryesore është vendosja e gjërave të tilla si ndryshimet teknike të produktit në një afat kohor në mënyrë që të jemi në gjendje të vlerësojmë se si këto ndryshime ndikojnë në tregues të tillë si përfitimi ose diferencimi. Ndërmjet të tjerash, ky afat kohor mund të ndihmojë me vlerësimin e ndryshimeve tek drejtuesit, grupet dhe institucionet që kanë marrë pjesë në proces.


Evidentimi i faktorëve të jashtëm që mund të kenë ndikim në procesin e TGJ është gjithashtu thelbësor, përfshirë këtu edhe ata që nuk janë të lidhur me të në mënyrë të drejtpërdrejtë. Këtu mund të përfshihen migrime të rëndësishme, programe publike për përmirësimin e proceseve të prodhimit, pamjaftueshmëri apo bollëk materiale për shkak të faktorëve mjedisorë. Këtu mund të përfshihen migrime të rëndësishme, programe publike për përmirësimin e proceseve të prodhimit, pamjaftueshmëri apo bollëk materiale për shkak të faktorëve mjedisorë.

Pyetjet që drejtojnë procesin e hartimit të afateve kohore përfshijnë:

- Çfarë ndryshimesh janë bërë në praktikat e prodhimit?
- Çfarë? dizajni apo prezantimesh ka pasur produkti?
- Cila është origjina e lëndës së parë të përdorur në prodhimin e saj?

- Çfarë drejtuesish, organizatash, sipërmarrjesh biznesi, apo institucionesh janë përfshirë me produktin?
- Çfarë faktorësh shoqërorë, kulturorë, ekonomikë apo mjedisorë kanë ndikuar në zinxhirin e vlerës së produktit?

Shembulli i afateve kohore për TGJ-në e “Qeramikat e Carmen de Viboral”



Këto afate kohore u zhvilluan nga komuniteti i artizanëve të Carmen de Viboral dhe janë pjesë e Muzeut të Qeramikës në Institutin e Kulturës së Bashkisë

3.2 Vlerësimi i kushteve dhe ndikimeve të procesit të TGJ

3.2.1 Seminar Praktik për Vlerësimin

Ky instrument përmban dy lloje vlerësimi: vlerësimin e kushteve të nevojshme për ndërtimin e një TGJ-je si dhe vlerësimin e ndikimeve të procesit të TGJ. Rekomandohet të mbahet një seminar praktik për të inkurajuar debatin, reflektimin dhe një analizë kritike të procesit të drejtuar nga pjesëmarrësit; kështu, ushtrimi mund të konsiderohet si vetë-vlerësim.

Seminari praktik mund të organizohet nga çdokush prej palëve të interesuara për të cilët është hartuar ky udhëzues (shihni pjesën 2.2). Planifikimi dhe kryerja e seminarit praktik duhet të bazohet në parimin e transparencës; është shumë e rëndësishme që informacioni i paraqitur të jetë i qartë dhe i tërësishëm dhe që lista e pjesëmarrësve t'i vihet në dispozicion kujtqdo që është i interesuar në këtë proces.

Organizatorëve u këshillohet të përdorin hartën e palëve të interesuara për të përcaktuar njerëzit që do të ftohen në seminarin praktik, si dhe të kërkojnë të sigurojnë përfaqësim të mjaftueshëm. Për ta arritur këtë, nuk është vetëm thelbësore që të paktën një palë e interesuar nga secila hallkë e zinxhirit të vlerës të thirret për të marrë pjesë, por që ky person të njihet si një palë e interesuar legjitime, e rëndësishme dhe e përshtatshme në nivelin vendor. Për më tepër, ky person duhet të ketë kapacitetin të ndikojë në rezultate. Vendi i zhvillimit të seminarit praktik duhet të jetë asnjëherë.

Seminari do të zgjasë katër deri në pesë orë dhe do të përfshijë dy aktivitete kryesore:

- Rishikimi, zgjerimi dhe vërtetimi i hartës së palëve të interesuara dhe afatet kohore, të cilat do të jenë krijuar para seminarit me qëllim mbështetjen dhe pasurimin e diskutimit (shihni pjesën 3.1).
- Vlerësimi i kushteve të nevojshme për krijimin e TGJ-së dhe ndikimet e procesit të TGJ-së (shihni pjesën 3.2.2).

Seminari praktik mund të drejtohet nga dikush që nuk është i përfshirë në procesin e TGJ-së dhe/ose një palë e interesuar në zinxhirin e vlerës. Është e rëndësishme që drejtuesit të kenë:

- Kohën dhe gatishmërinë të studiojnë këtë udhëzues përpara zhvillimit të seminarit praktik.
- Kapacitetin për të promovuar pjesëmarrje të hapur dhe miqësore të pjesëmarrësve.
- Aftësinë për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme dhe për t'u përqendruar në kontributet e të gjithëve.

Duke marrë parasysh faktin se ky është një seminar praktik i përqendruar në vetë-vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve të procesit të TGJ, në asnjë moment drejtuesi nuk mund të marrë pjesë në vlerësim. Një pikëpamje plotësuese mund të ofrohet nga një moderator i jashtëm vendor: ky person ndihmon që procesi i vlerësimit të ngelet i paanshëm, ndërkohë që moderatorin vendor ndihmon në përshtatjen e instrumentit me kontekstin.

Aty ku është e mundur, këshillohet që në një procesi të ndarë të TGJ-së të përfshihet një moderator i tretë. Kjo gjë do të mundësojë shkëmbimin e përvojave gjatë zbatimit të instrumentit, të mësuarit nga kolegët si dhe transferueshmërinë e vlerësimit.

Gjatë zhvillimit të seminarit praktik për vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve, këshillohet të keni përgatitur artikuj kancelarie për regjistrimin e vlerësimeve dhe komenteve. Për këtë qëllim mund të përdoren tabakë të mëdhenj letre, ku mund të shënohen vlerësimet dhe komentet që t'i shohë çdo pjesëmarrës. Gjithashtu, është e mundur që informacioni të plotësohet në këtë udhëzues, si në formatin elektronik ashtu edhe në atë fizik.

CONDICIONES NECESARIAS

DEFINICION

1. **COMPENSIÓN** (Scale: 1-5)
2. **LEGITIMIDAD PROTECCIÓN** (Scale: 1-5)
3. **REGLAMENTO DE USO** (Scale: 1-5)

USO DEL SELLO

1. **ANTICIPACIÓN DEL SELLO** (Scale: 1-5)
2. **USO DEL SELLO** (Scale: 1-5)

GOBERNANZA

1. **ORGANIZACIÓN GUBERNAL** (Scale: 1-5)
2. **SOBERANÍA FINANCIERA Y SERVICIOS** (Scale: 1-5)
3. **MECANISMOS DE COMUNICACIÓN** (Scale: 1-5)
4. **SISTEMA DE CONTROL** (Scale: 1-5)
5. **SISTEMA DE MONITOREO Y EVALUACIÓN** (Scale: 1-5)

Handwritten notes in Spanish provide detailed explanations for each item, such as 'Elaboración de un plan de trabajo', 'Elaboración de un plan de trabajo', 'Elaboración de un plan de trabajo', etc.

Nëse seminari ka më shumë se sa dhjetë pjesëmarrës, rekomandohet metoda e "World Café³", pasi mundëson një drejtim më të mirë të tij. Rekomandohet gjithashtu që pjesëmarrësit të jenë përgjegjës për të vendosur nëse vlerësimi do të bëhet hapur ose në fshehtësi; nëse zgjedhin këtë të fundit, duhet të llogaritet mesatarja e rezultateve dhe kjo gjithsesi duhet të pasohet nga një diskutim, gjatë të cilit të regjistrohen komentet. Nëse një diskutim i hapur nuk është i këshillueshëm sepse pjesëmarrësit nuk do të shprehnin mendimet e tyre lirisht për shkak të dinamikës lokale të energjisë, mund të konsiderohet një metodë alternative e mbledhjes së të dhënave, siç është intervistimi.

3. Për më shumë informacion rreth kësaj metode, vizitoni www.theworldcafe.com

3.2.2 Matricat e Vlerësimit

Matricat përmbajnë një përkufizim të asaj që synojnë të vlerësojnë kushtet dhe treguesit, si dhe një hapësirë për të plotësuar vlerësimet dhe komentet. Në këtë udhëzues, ato ndahen në dy grupe:

Grupi i parë i matricave përmban tre kushtet kryesore: (i) Përkufizimin dhe mbrojtjen e TGJ-së, (ii) administrimin e vulës së TGJ-së, si dhe (iii) drejtimin e TGJ-së. Çdo kusht përmban një grup nën-kushtesh, të cilat vlerësohen sipas një sistemi klasifikimi me pikë nga 1 deri tek 5.

Më poshtë jepen tre shembuj të skenarëve të mundshëm për çdo nën-kusht:


- 1 përfaqëson vlerësimin më të ulët dhe sinjalizon kushtet e pasigurta.
- 3 është vlerësimi mesatar dhe sinjalizon pak progres.
- 5 është vlerësimi më i lartë dhe sinjalizon që kushti është plotësuar.

Grupi i dytë i matricave përbën treguesit e ndikimit që u korrespondojnë katër dimensioneve: shoqërore, kulturore, ekonomike dhe mjedisore. Çdo matricë trajton një nga këto dimensionet me treguesit e vetë përkatës dhe shtron pyetjen nëse procesi i TGJ-së ka ndikuar apo jo tek treguesi. Jepet hapësirë për të vlerësuar ndikimin në një shkallë nga -5 deri tek 5 dhe për regjistrimin e komenteve që justifikojnë këtë vlerësim. Kjo mundëson krahasimet dhe vëzhgimin e ndryshimeve në të ardhmen.



**Shpjegimi hap - pas - hapi
për mënyrën e vlerësimit të
kushteve dhe ndikimeve**

Hapat për vlerësimin e kushteve



Shembull: TGJ Xhelatina Gujava Bocadillo Veleño


Kushti 3.2

Qëndrueshmëria dhe shërbimet financiare

Vlerësimi:

- 1** Shoqata tregtare nuk është financiarisht e qëndrueshme dhe as nuk ofron shërbime për anëtarët e saj.
- 3** Shoqata tregtare është disi e qëndrueshme financiarisht falë mbështetjes së jashtme dhe ajo u ofron disa shërbime anëtarëve të saj.
- 5** Shoqata tregtare është e qëndrueshme financiarisht dhe ofron disa shërbime për anëtarët e saj, si p.sh.; trajnim, mbështetje për formalizimin, kërkimin në zinxhirin e vlerës, etj.

Vlerësimi i kushtit



Komente

Statutet e shoqatës së prodhuesve Fedeveleños përmbledhin shërbimet që ajo shpreson të jetë në gjendje t'ua ofrojë anëtarëve të saj. Shoqata pranon rëndësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve në mënyrë të efektshme. Aktualisht, ka evidentuar një mungesë burimesh dhe mekanizmesh financimi që do t'i mundësonin këtë gjë.

Hapat për vlerësimin e treguesve

TREGUESI:

1. Besimi dhe solidariteti

PYETJA

A ka pasur procesi i TGJ-së një ndikim tek ...?

Ndërtimi i besimit dhe solidaritetit ndërmjet palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës. Shembull: Ndryshimet në llojin dhe shpeshtësinë e dialogut apo ndërveprimit ndërmjet palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës.

DIMENSIONI

Dimensioni Social

FUSHA E VLERËSIMIT

Impact	
(PO) (JO)	(POZITIV) (NEGATIV)

0 1 2 3 4 5

Vlerësimi nga 1 në 5

Komente

KUTIA E KOMENTEVE


Shembull: TGJ Xhelatina Gujava Bocadillo Veleño

Tregues

1. Besim dhe solidaritet

A ka pasur procesi i TGJ-së ndikim tek...?

Ndërtimi i besimit dhe solidaritetit ndërmjet palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës. Shembull: Ndryshimet në llojin dhe shpeshtësinë e dialogut apo ndërveprimit ndërmjet palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës.



Komente


Procesi i TGJ-së ka çuar drejt krijimit të hapësirave për debat që kanë ndërtuar besim tek palët e interesuara dhe kanë krijuar ndjesinë e transparencës më të madhe për sa i përket procesit. Megjithatë, ka qenë e vështirë të ndërtohej besimi dhe solidariteti për shkak të interesave të veçanta të secilës lidhjeje të zinxhirit të vlerës.

Metoda të tjera vlerësimi:

Si një mënyrë për të plotësuar seminarin për vlerësimin e kushteve dhe ndikimeve, rekomandohet përdorimi i sondazheve në letër apo në internet, (si SurveyMonkey), intervista gjysmë të strukturuar dhe/ose studime teknike. Studimet teknike shërbejnë për të prodhuar informacion objektiv në lidhje me ndryshimet e vërejtura në tregues të tillë si shpërndarja e vlerës në të gjithë zinxhirin, përfitimi dhe cenueshmëria ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve. Duhet të përdoret çdo informacion dytësor i disponueshëm në lidhje me treguesit. Si informacioni parësor ashtu edhe ai dytësor mund të shërbejnë qoftë në mbështetje të diskutimeve gjatë seminarit praktik, ashtu edhe për të minimizuar subjektivitetin në vlerësime. Shembuj:

Dimensioni	Tregues	Studim
Dimensioni shoqëror	1. Besim dhe solidaritet 2. Bashkëpunimi	Sondazh mbi kapitalin shoqësor
Dimensioni kulturor	1. Vlerësim i produktit 2. Marrëdhënie me forma të tjera të shprehjes kulturore 3. Ringjallja dhe transmetimi 4. Zakonet e konsumimit 5. Vlerësimi i tregtisë	Etnografi
Dimensioni ekonomik	1. Përfitimi 2. Ndarja e tregut 3. Diferencimi 4. Shpërndarja e diferencimit	Studim tregu Analiza e zinxhirit të vlerës
Dimensioni mjedisor	1. Cenueshmëria ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve 2. Uji	Studim mbi humbjen e biodiversitetit Gjurmë uji
	3. Cilësia e ajrit 4. Efikasiteti i energjisë	Gjurmë karboni
	5. Toka 6. Nënproduktet dhe mbetjet	Studim i tokës Gjurmë ekologjike Gjurmë transporti

Kushtet e nevojshme për ndërtimin e një TGJ-je



Kushti 1: TGJ përkufizimi dhe mbrojtja



Kushti 1.1 Të kuptuarit

Vlerësoni si e kupton një palë e interesuar e zinxhirit të vlerës çfarë është TGJ-ja dhe pse është e rëndësishme të aplikohet për mbrojtje të produktit të tyre.

Vlerësimi:

1

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës kanë dëgjuar rreth TGJ-së por nuk janë të sigurt se çfarë është apo se përse u nevojitet.


3

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës e dinë se çfarë është TGJ-ja dhe se çfarë ka për synim të mbrojtje, por nuk janë të sigurt se përse u nevojitet për produktin e tyre.

5

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës e dinë se çfarë është TGJ-ja dhe bashkërisht evidentojnë nevojën për mbrojtje të tillë.

Vlerësimi për kushtin:



Vlerësimi
nga 1 në 5

Komente

Kushti 1.2

Kodi i praktikës

Vlerësoni ekzistencën e kodit të praktikës, njohuritë për atë që duhet të përmbajë, si dhe pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të vlerës në procesin e përcaktimit të tij.

Vlerësimi:

1

Nuk ka një kod të praktikës, palët e interesuara të zinxhirit të vlerës nuk dinë se çfarë është, çfarë duhet të përmbajë apo për çfarë është dhe nuk ka asnjë organizatë që mbështet procesin që e përcakton atë.


3

Ekziston një kod praktike që nuk është përcaktuar nga palët e interesuara të zinxhirit të vlerës, por palët e interesuara e kuptojnë rëndësinë e miratimit të tij apo përcaktimin e një kodi të ri që ata mendojnë se i përfaqëson më mirë, si dhe ndarjen me çdo palë të interesuar dhe zbatimin e tij.

5

Ka një kod praktike që ishte rezultati i një procesi pjesëmarrjeje. Përmban të gjithë elementët e nevojshëm, po zbatohet dhe palët e interesuara të zinxhirit të vlerës janë të njohur me të.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 1.3 Zbatimi për mbrojtje

Vlerësoni pjesëmarrjen, informacionin në dispozicion dhe përfaqësimin e interesave të aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të vlerës në procesin e aplikimit për mbrojtje.

Vlerësimi:

1

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës nuk janë të njohur me procesin e aplikimit për mbrojtjen e TGJ-së dhe nuk e dinë se si mund të marrin pjesë.


3

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës janë të njohur me disa hapa në procesin e aplikimit për mbrojtjen e TGJ-së dhe kanë marrë pjesë në disa aktivitete të lidhura me të.

5

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës janë të njohur me procesin e aplikimit dhe elementet normative që e shoqërojnë dhe ata marrin pjesë në proces.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 2: Administrimi i vulës së TGJ-së

Kushti 2.1 Autorizimi i vulës

Vlerësimi:

1

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës nuk janë të njohur me procesin e autorizimit dhe nuk e njohin organin ose organizatën që autorizon përdorimin e vulës.


3

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës e njohin organin që autorizon dhe rregullon përdorimin e vulës dhe mund të identifikojnë disa nga hapat e kërkuar për marrjen e autorizimit. Një grup i vogël i prodhuesve apo artizanëve të mundshëm është i autorizuar.

5

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës e njohin organin që autorizon dhe rregullon përdorimin e vulës dhe mund të identifikojnë hapat e kërkuar për marrjen e autorizimit. Një numër i madh i prodhuesve apo artizanëve të mundshëm janë të autorizuar.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 2.2

Aftësia për autorizim dhe sistemi i kontrollit

Vlerësoni nëse shoqata tregtare e ka aftësinë për të autorizuar përdorimin e vulës dhe nëse ka aftësinë për të kontrolluar përdorimin pa ndikuar në nivelet e besimit.

Vlerësimi:

1

Shoqata tregtare nuk ka aftësi për të autorizuar përdorimin e vulës, nuk ka asnjë sistem kontrolli për përdorimin e vulës dhe shoqata tregtare dhe anëtarët e saj nuk janë në dijeni të rëndësisë së këtyre elementeve.


3

Shoqata tregtare ka aftësinë për të autorizuar përdorimin e vulës dhe ka një sistem kontrolli që është hartuar me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj, por masat e kontrollit nuk zbatohen.

5

Shoqata tregtare ka aftësinë për të autorizuar përdorimin e vulës, një sistem kontrolli që është hartuar me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj dhe kapacitetin njerëzor dhe financiar për të zbatuar masat e vendosura të kontrollit pa dëmtuar besimin.

Vlerësimi për kushtin:



Vlerësimi
nga 1 në 5

Komente

Kushti 2.3 Administrimi i vulës së TGJ-së

Vlerësoni si dhe kur e përdorin palët e interesuara të zinxhirit të vlerës* vulën TGJ.

* Ky kusht zbatohet vetëm për palët e interesuara të zinxhirit të vlerës që do ta përdorin vulën.

Vlerësimi:

1

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës që janë të autorizuar të përdorin vulën e TGJ-së nuk e përdorin atë për të dalluar produktin e tyre dhe nuk janë të qartë se si ta përdorin atë.


3

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerave ndonjëherë e përdorin vulën e TGJ-së në disa produkte kur ata marrin pjesë në panaire dhe/ose kur organi autorizues dhe rregullues u jep atyre etiketa apo ngjitëse me vulën e stampuar.

5

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës që janë të autorizuar të përdorin vulën e TGJ-së e përdorin atë për të dalluar produktin e tyre në tregje të ndryshme dhe e bëjnë këtë në mënyrë autonome ose në përputhje me rregullat që janë përcaktuar.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 2.4 Promovimi i vulës TGJ

Vlerësoni nëse ka nisma për të promovuar vulën e TGJ për produktin që ndihmon në parandalimin e plagjiaturës ose konkurrencës së pandershme.

Vlerësimi:

1

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës dhe/ose shoqatat tregtare nuk promovojnë gjerësisht njohjen e vulës së TGJ-së ndërmjet konsumatorëve, industrive ose bizneseve lokale. *

3


Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës dhe/ose shoqatat tregtare promovojnë njohjen e vulës së TGJ-së ndërmjet konsumatorëve, industrive dhe bizneseve lokale, por mungesa e ndërgjegjësimit vazhdon dhe kjo nuk ndihmon për të parandaluar kopjet apo konkurrencën e padrejtë.

5

Palët e interesuara të zinxhirit të vlerës dhe/ose shoqatat tregtare promovojnë gjerësisht njohjen e vulës së TGJ-së ndërmjet konsumatorëve, industrive dhe bizneseve lokale, dhe kjo ndihmon në parandalimin e kopjeve dhe konkurrencës së pandershme.

* Ky kufizim në nivelin lokal mund të hiqet për të përfshirë nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare kur përshtatet instrumenti.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 3: TGJ Drejtimi

Kushti 3.1 Shoqata tregtare

Vlerësoni legjitimitetin e shoqatës tregtare dhe kapacitetin e saj për të menaxhuar TGJ-në dhe për t'u mobilizuar rreth saj.

Vlerësimi:

1

Nuk ka asnjë shoqatë tregtare që përfaqëson apo administron interesat e palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës.


3

Ekziston një shoqatë tregtare me një farë legjitimiteti midis palëve të interesuara të zinxhirit të vlerës për të menaxhuar interesat e tyre në lidhje me TGJ-në. Ajo arrin të bëjë që anëtarët e saj të marrin pjesë në vendimmarrje, por nuk mobilizon palë të interesuara të jashtëm dhe/ose jo-anëtarë.

5

Ekziston një shoqatë tregtare me legjitimitet midis aktorëve të zinxhirit të vlerës për të menaxhuar interesat e tyre në lidhje me TGJ-në. Ajo arrin të bëjë që anëtarët e saj të marrin pjesë në mënyrë aktive në vendimmarrje dhe të bashkërendohen me palë të interesuara të jashtëm dhe/ose jo-anëtarë.

Vlerësimi për kushtin:



Vlerësimi
nga 1 në 5

Komente

Kushti 3.2 Qëndrueshmëria dhe shërbimet financiare

Vlerësoni qëndrueshmërinë financiare të shoqatës tregtare dhe aftësinë e saj për të ofruar shërbime në lidhje me TGJ-në.

Vlerësimi:

1

Shoqata tregtare nuk është e qëndrueshme financiarisht dhe as nuk ofron shërbime për anëtarët e saj.


3

Shoqata tregtare është disi e qëndrueshme financiarisht falë mbështetjes së jashtme dhe ofron disa shërbime për anëtarët e saj.

5

Shoqata tregtare është e qëndrueshme financiarisht dhe ofron disa shërbime për anëtarët e saj, siç janë: trajnimi, mbështetja për zyrtarizimin, kërkime në zinxhirin e vlerës, etj.

Vlerësimi për kushtin:



Komente

Kushti 3.3

Mekanizmat e komunikimit

Vlerësoni efikasitetin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të shoqatës tregtare.

Vlerësimi:

1

